

GJYSHJA, PLAKU NË TË BARDHA DHE UNË

Nga Dimal Basha

Si fëmijë qëndronim me javë tek dajtë në fshat. Ishte një lloj tradite ku e ëma me dy motrat së bashku me fëmijë kalonin pushimet verore tek dajtë. Babai, i ikur nga Shqipëria, nuk mund të vizitonte familjen e tij asnjëherë. Mblidheshim në shtëpinë e gjyshes në fshatin Balaj, që kishte pesë kilometra nga Ferizaji. Aty jetonin gjyshi me gjyshen, dy dajtë me bashkëshortet e tyre, si dhe tetë fëmijët e tyre. Ne ishim vetëm tre fëmijë, mirëpo së bashku me dhjetë fëmijët e tezeve dhe mbi tetë prej tyre tek dajtë, krijonim një familje të madhe të zgjeruar prej tridhjetë vetësh. Pasi asnjëri nga ne nuk kishim mundësitë për të kaluar pushimet diku tjetër, pushimet te dajtë ishin gjëja më e përafërt e vizitës së një kompleksi turistik.

Ishte një shtëpi e ndërtuar prej balte që kishte tri dhoma gjumi dhe çdo cep i saj zптоhej gjatë muajve të verës. Në fund të oborrit ishte një ndodhej edhe një ndërtim i veçantë, oda. Ishte më e madhe se një dhomë e zakonshme dhe gratë zakonisht nuk lejohenin aty. Fotografitë në librat e historisë më kishin lënë përshtypje dhe dhoma dukej se i përngjante hapsirës ku është mbajtur Kongresi i Lezhës, ku pesë qind vite përpara, heroi ynë kombëtar Gjergj Skënderbegu mblodhi gjithë fiset shqiptare për të luftuar Perandorinë Osmane. Natën megjithatë, për shkak të mungesës së hapësirës, pa ndonjë ceremoni oda shëndrrohej në kamp të fjetjes për të gjithë fëmijët.

Ne ishim në pushime duke lozur derisa gratë ishin të zëna me orar të ngjeshur të punës. Ishin të parat që zgjoheshin në mëngjes dhe të fundit që binin të flinin, që përngjante në punëtorët në kooperativat e komunizmit së Shqipërisë. Kjo rutinë ishte normale për atë kohë, kurse sot lirisht mund të krahasohet me një kamp punëtorësh të Koresë Veriore.

Detyra më e vështirë e grave ishte të vinin në gjumë fëmijët, një ankth i tmerrshëm dhe mision i pamundur. Për të shpejtuar procesin, gjyshja shpesh na kërcënonte, “Flini, ose do të vij plaku në të bardha!”

Imagjinata ime e shkëlqyeshme kristalizonte vizualizimin e këtij plakut në të bardhë. Sikur gjyshja të dinte vetëm përafërsisht figurën e frikshme që kisha krijuar në kokën time, jam i sigurtë që edhe ajo do të tmerrohej. Nuk e kam dyshuar asnjëherë që ajo nuk donte të na lëndonte. Jam i sigurtë që ajo, sikur edhe gjithë gratë tjera, ishin të të stërlodhura dhe qëllimin e vetëm e kishin të na dërgonin sa më shpejt në shtrat. Mirëpo kërcënimi i gjyshes ishte traumatizues dhe qëllimi i saj për të shpejtuar gjumin tonë vetëm çka krijonte kundë-produktivë.

Derisa qëndroja i shtrirë, figura e plakut me rroba të bardha vinte duke u përsosur në imagjinatën time dhe sytë silleshin gjithandej duke pritur shfaqjen e tij. Sa herë që era hynte brenda përmes të çarave të dritareve të vjetra të drurit krijonte një zhurmë që më bënte të dridhem nga frika.

Pas një nate të gjatë pagjum, u ankova te gjyshja se kurdo që na kujtonte plakun unë nuk mund të flija. Ajo u ndje keq dhe më ledhatoi derisa shikonte përtej dhomës. Qëndrova për një momente nën krahërorin e saj, kur papritmas ngriti kokën dhe sikur u kujtua diçka dhe më tha,

“E di si të mos kesh frikë më. Duhesh të mësosh disa lutje dhe nuk do të kesh frikë më. Kurdo që djalli të afrohet, ti do të lutesh dhe ai ikën”.

Mbeta i shtangur! Konkludimi i parë që kaploi trurin tim të njomë ishte se plaku i vjetër në të bardhë ishte vetë djalli. Gjyshja nuk e shpjegoi më shumë derisa vazhdoi rutinën e saj derisa unë nuk gjatë gjithë ditës insistoja tek ajo që të m’i shkruaj lutjet në një letër ku mund t’i mësoja menjëherë.

Më në fund gjyshja më dha një copë letre me lutjet në të. Nuk mund të kujtoj se kush në fakt i shkroi pasiqë gjyshja nuk dinte shkrim-lexim. E hapa letrën dhe pasi i hodha një sy, vure re se nuk kuptoja asnjë fjalë që ishte shkruar. Shkronjat ishin shqip por leximi i tyre nuk tingëllonte i tillë.

Gjyshja më spjegoi se ishin në arabisht. “Janë sikur ato lutjet që i ndëgjon kur hoxha thërret ezan.” “Po pse në arabisht?” e pyeta unë. “Është gjuha e Zotit”, tha ajo duke më shikuar me një shikim të ngrohtë dhe sikur fitoi një simpati më të madhe tani që u përkushtova të mësoja “Gjuhën e Zotit”.

Për një moment u hamenda duke pyetur veten pse Zoti kupton vetëm arabishten? Mirëpo nga frika e plakut në të bardha e suspendova këtë gjykim dhe vazhdova drejt dhomës së gjyshes. Ishte e vetmja dhomë e qetë në shtëpi sepse fëmijët nuk lejoheshin të luanin dhe ishte hapësira më e mirë për të mësuar lutjet i qetë. Në atë kohë Zoti ishte një koncept që nuk e kuptoja aspak dhe arsyea pse isha i shtyer të mësoj lutjet nuk ishte besimi por frika nga plaku në të bardha. Ai ishte ngulitur në mendjen time dhe i premtova vetes se do të bëja gjithëçka në fuqinë time për të ndaluar atë të kalonte nga të çarat e dritares.

Shpenzova gjithë ditë duke mësuar lutjet. Ishin tri gjithsej dhe njëra ishte shumë e gjatë. Në shkollë isha shumë i mirë në memorizimin dhe recitimin e poezive. Shumica e poezive ishin nga Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Anton Zako Çajupi dhe shumë poetë të famshëm shqiptarë, koleksioni i të cilëve gjindej në bibliotekën e shtëpisë. Por lutjet që tani kisha para vetes ishin të vështira për dy arsye. E para, sepse nuk mund t’i shqiptoja, dhe e dyta, nuk mund t’i kuptoja dhe nuk mund të lidhesha emocionalisht si me poezitë e Çajupit për shembull.

E pyeta gjyshen si të shqiptoja një fjalë që tingëllonte vështirë. Ajo nuk e lexoi meqë nuk dinte të lexonte, por nisi të thonte lutjen nga fillimi dhe u ndal tek fjala që kisha vështirësi dhe e përsëriste me mua.

Në fund tha se duhet të fokusohesha vetëm në një lutje. “Cilën” e pyeta. “Këtë që e përsëritëm së bashku”, më përgjigj gjyshja. Ishte e para dhe nuk ishte e gjatë. “Kjo është shumë e mirë”, tha ajo. “Kurdo që e reciton, dy enguj do ulen në shpatullat e tua, njëri në të majtë, tjetri në të djathtë, dhe do të të mbrojnë nga djalli. Kur djalli i sheh engjujt, do të largohet”.

As për edhe një sekondë nuk i dyshoja fjalët e gjyshes. Isha i preferuari i saj, ose të paktën ashtu

ndihesha. Pasi i morra këshillat e shqiptimit dhe tregimin e saj për engjujt, vazhdova të përsëris lutjen në dhomë. U ndjeva mirë për momentin, por pastaj fillova t'i paramendoj engjujt duke u ndalë në shpatullat e mija, dhe të them të drejtën, edhe ky mendim më tmerronte.

Gjyshja sapo kishte konfirmuar ekzistencën e krijesave imagjinare. Besoja se këto krijesa nuk jetonin vetëm në ëndërrat apo në imagjinatën time, tani i perceptoja si të vërteta dhe gjithashtu krijesa që kishin mundësinë të përvjedheshin brenda dhomës përmes të çarave të dritareve. Pjesa tjetër e këtij tmerrri ishte lufta që zhvillohej mes këtyre dy forcave, djallit në një anë dhe engjujt në anën tjetër.

Ditën e parë e kalova duke mësuar lutjen e parë. Atë më të mirën, sipas gjyshes. Pasi ra nata, ne shkuam për të fjetur dhe fillova të përshpëris lutjen me qindra herë. Netëve tjera, ne fëmijët përshpërisnim në mënyrë që të rriturit të mos na dëgjonin meqë shpesh n'a kontrollonin nëse kishim fjetur. Unë përshpërisja më së shumti për të mbajtur të tjerët zgjuar sepse nuk doja të isha vetëm i zgjuar në rast se plaku në të bardhë do të na vizitonte. Asnjëherë nuk e kisha menduar, çka nëse ai vinte derisa ishim fjetur? Do të ishte më logjike të rrinim zgjuar dhe ta presim, meqë do të kishim mundësi më të mirë për të ikur. Por jo! Unë kisha vetëm një qëllim, të më zinte gjumi sa më shpejtë që ishte e mundur sepse gjumi ishte shpëtimi i vetëm nga një takim i llahtarshëm me djallin.

Pëderisa përshpërisja lutjen e vetme, fëmijët tjerë shpesh përshpërisnin në drejtimin tim. I injoroja dhe njëkohësisht shpejtoja lutjen time, duke u frikësuar se do të harroja ndonjë fjalë. Sigurohesha të shqiptoja secilën fjalë drejt, duke u frikësuar se Zoti nuk do të kuptonte arabishten time të mësuar në shqip.

Ekzistenca ime mvarej nga ajo lutje dhe ishte qenësore që engjujt të ishin pranë derisa të më zinte gjumi. Sa herë që ndaloja pëshpëritjen e lutjes, mendja fillonte të imagjinonte luftën mes engjuve dhe djallit që synonte sundimin tonë. Por tani isha i pajisur me një copë letre që më premtonte se krijesat imagjinare mbi shpatullat e mija do të shërbenin si roje gjatë natës. E mbaja atë copë letër përfundi jastakut ashtu siç bëja me veprat e Çajupit. Ishte një strategji që përdornim si fëmijë, që na ndihmonte t'i memorizonim më shpejt poezitë derisa flinim.

Ëndërrat më dukeshin të mërzitshme sepse më zgjonin në mes të natës. Kjo më tmerronte sepse fillonte prapë rutina e recitimit të një lutjeje që e dija, dhe më lajmronte që isha i vetmi zgjuar.

Në atë kohë i kisha inat edhe ëndërrat sepse ato shpesh më zgjonin në mes natës dhe ky fakt më trishtonte sepse e para, filloja rutinën e pafund të lutjes së vetme dhe e dyta, tani të gjithë flinin dhe unë isha i zgjuari i vetëm në dhomë.

Për çudi, këto mendime të rrëmbyeshme ishin prezente vetëm gjatë natës. Gjatë ditës nuk kishte errësirë, gjithëçka ishte e ndriqar dhe frika që ndjeja zhdukej, por jo gjithmonë. Kjo ishte pasojë

e një tregimi tjetër të gjyshes.

Ajo më kishte thënë se se ky plaku në të bardha, ose personifikimi i djallit në mendjen time, gjatë ditës fshihej në pyll. Duke qenë në dijeni të kësaj, gjatë ditës isha absolutisht kundër vizitës në pyll pa një të rritur. Kjo i bënte gjërat shumë të vështira, meqë shumë shpesh urdhëroheshim të shkonim në pyll për të mbledhë dru me një karrocë të vogël, që gjithashtu ishte një mënyrë për “të fituar racionet e ushqimit”. Pavarësisht se mund të më refuzohej një shujtë, shpesh refuzoja të shkoja.

Kurdo që shkoja, që ishte shumë rrallë, sigurohesha që të jemi tre apo katër vetë. Kur djali më i madh i dajës shkonte i vetëm në pyll, mendoja se ishte njeriu më i trim njohja. Jo pse kishte mbledhë më shumë dru se ne, por sepse nuk i frikësohej pyjeve. Isha i bindur se edhe ai ishte në dijeni për krijesat e frikshme që rrinin në pyll gjatë ditës.

Mirëpo lutja më shërbente vetëm në errësirë, jo gjatë ditës, por unë recitoja kur qentë endacak kalonin afër meje. Ky sygjerim për lutjet ndaj qenve ishte e çunit të tezes që më rrëfente se si gjyshen asnjëherë nuk e ndiçnin kur kthehej këmbë vonë natën nga ndonjë vizitë në farefis.

Nuk hezitova të mësoj edhe dy lutje të tjera. I përshpërisja pafundësisht derisa i zotërova mirë. Përshpëritja shpesh më bënte kureshtar. Lutja nuk ishte si recitimi i një poezie apo këndimi i një kënge. Recitimi ishte i bukur dhe isha anëtar i grupit recitatorë të shkollës; por lutja nuk ishte recitim. Isha urdhëruar që lutjet “duhet t’i them me vete, në mendjen time”.

Asnjëherë nuk kam qenë këngëtar i mirë, por mësuesi i muzikës gjithmonë më linte pesë për të mos më prishur notën mesatare. Mirëpo lutjet nuk ishin as këngë. Ishin një grumbull fjalësh të shkruara në shqip me shqiptim arabik, të cilat isha i supozuar t’i përshpërisja në mendje dhe si dhuratë fitoja dy enguj që qëndronin në shpatullat e mija si roje ndaj djallit. Vetëm mendimi i dy engujve të bardhë mbi shpatulla që vëshgonin rrëzikun nga djalli ishte një lehtësim brenda vetes.

Ka qenë shumë më vonë kur dëgjova këngë në gjuhën e Zotit. Kjo ndodhi gjatë një mevludi, që quhej ngjarja ku mblidheshin për të përkujtuar një të vdekur. Gjithmonë insistoja t’i bashkangjitesha të rriturve kur shkonin si të ftuar. Më rastisi të jem në një mevlud së bashku me burra të tjerë të familjes së dajës, imamin e fshatit dhe disa të rinjë. Aty ishte hera e parë ku dëgjoja këngë në gjuhën e pëshpërimave që luftonin djallin.

Të gjithë të pranishmit në këtë ngjarje ishin ulur të qetë me fytyrat e mërzitura. Qëndroja i qetë në një qoshe me pytje të panumërta që më sillleshin në mendje. Dyshoja se nuk isha i vetmi që nuk e kuptoja gjuhën që për sa kohë isha duke e përshpëritur. Asnjëri prej burrave nuk dukej që po e kuptonte, ndoshta përveç imamin. Jam rritë duke dëgjuar këngë në gjuhën angleze tekstet e të cilave nuk i kuptoja, por ishte gjithmonë melodia që më joshte. Nuk kishte diçka të veçantë në

mevlud. Nuk kishte instrumente muzikore. Ishin një turme prej pesë-gjashtë vetash që qëndronin në mes të dhomës duke shikuar përpjetë duke kënduar në një gjuhë që as unë, por as ata nuk e kuptonin.

Kjo ishte një shfaqje e hatashme, mendoja me vete. Por duhet t'a mbaja në vetëvete këtë dyshim sepse isha i ri, dhe të rriturit nuk do të hezitonin të më tregonin vendin nëse kisha ndonjë pyetje "pa vend." "Ulu i qetë, je shumë i vogël për të kuptuar", ishte përgjigja e tyre kur pyesja diçka që nuk u pëlqente. Ka qenë vonë gjatë jetës kur kam kuptuar se mosha nuk ishte matësi më i mirë i intelegjencës.

Kori u ndal për një pauzë të shkurtë. Atëherë i'u afrova një prej djelmoshave që këndonte dhe e pyeta, "Për çfarë bënte fjalë kënga e fundit?" "Janë psalme qiellore që i kushtohen Zotit", tha ai. "Mirë, shumë mirë", thash unë. "Por çfarë thotë teksti? A e kupton arabishten?" "Jo, jo nuk e kuptoj, por ne jemi mësuar të memorizojmë dhe të këndojmë këto," tha ai duke më shikuar i hutuar. Si duket ishte një pyetje tjetër "pa vend."

Hmmm, thash me vete, gjithë ky festim i shoqëruar me muzikë pa instrumente, kënduar nga të rinjtë që shikojnë nga tavani ndërkohë që nuk kuptojnë këngët e tyre! Ishte një kor jo fort gazmorë, megjithatë, qetësia gjatë këndimit më jipte të besoj se turma e burrave dukej që po gjente paqë në ato melodi. Ndonjëherë ndiznin ndonjë cigare dhe në mënyrë ceremoniale merrnin nga një pjesë mishi nga pjatat para tyre, gjithmonë qetë me kokën ulur poshtë.

A ju tregova që nuk kishte gra të pranishme aty? Ato vetëm u lajmronin kohë pas kohe deri tek hyrja për të shërbyer pjatat me mish. Qëndronin të ndara dhe nuk e di në qoftë se kanë pas ndonjë kor që për t'i ngushlluar. Sidoqoftë, unë vazhdova të vëzhgoja shfaqjen e burrave për së afërmi. Isha i mahnitur me "gjuhën e pakutpueshme të Zotit" dhe çka ishte edhe më fascinuese se të gjithë, përfshirë edhe mua, ishim pjesë e pandashme e kësaj gjuhe. Janë gjithë këto momentet e një udhëtimi tim në një botë që nuk e kisha njohur më parë dhe ende çdo detaj mbetet i kristalizuar në mendjen time. Vetëm vonë pasi kam lexuar studime të ndryshme në psikologji kam kuptuar se kujtimet tronditëse në jetën e njeriut mbeten ato më të freskëtat.

Gjyshja ishte e paarsimuar por që kishte një dashuri për të gjithë dhe përkujdesej për ne në mënyrën më të mirë që dinte. Në shtëpi lutej pesë herë në ditë, duke përshpëritë gjuhën e Zotit, dhe e paramendoja se gjithë ato lutje ajo vuante nga djalli shumë më shumë se unë. Ka kujtime të shumta që më lidhin me gjyshen por tregimet e saj për plakun e vjetër në të bardhë, engjujt, dhe gjuha e Zotit, ishin shumë të veçanta. Ishte hera e parë kur imagjinata ime u shndërrua në film horror. Para tregimeve të krijesave mendja ime e njomë kishte vetëm ëndrrat e një veture të kaltër, ose ëndrra që të jem pjesë e një ekipi të famshëm futbollistik. Mirëpo krijesat e frikshme kishin përmbysur gjithë ëndrrat e bukura që kisha.

Plakun në të bardhë, të cilin gjyshja ma prezentoj, dhe më pas engjëjt të dërguar për të më

mbrojtur nga ai, më bënë të ndihem si një zog i stokuar në çerdhen e tij. Prezentimi i Zotit, gjuha e tij e zgjedhur, dhe ushtarët e tij ishin të supozuar të ndihmonin, mirëpo efekti ishte i kundërt. Më vonë e kuptova se jo vetëm gjyshja dhe unë, por ishte edhe vet Zoti që ishte në luftë me djallin, që më bënte të dyshoj në plotëfuqinë e tij.

Plaku i vjetër në të bardhë mbetet kujtim i hidhur, por jo edhe dashuria për gjyshen. Hera e fundit kur u pamë ishte koha kur vendosa të largohesha nga Kosova për të kërkuar një të ardhme më të ndritur jasht vendit, si shumë të tjerë. Ishim vetëm ne të dy kur u përshëndetëm. Dukej shumë e mërzitur. E përqafova fort dhe i thash, “Do takohemi shumë shpejt”. “Nuk e besoj. Tani po ikën larg. Këtu sadopak të shihja ndonjëherë”. Dhe ashtu ndodhi. Nuk u pamë më!

(Një verzion pak më ndryshe është publikuar në Kosovo 2.0)